

**LISTA E ORGANIZATAVE DHE  
STREHËZAVE QË PUNOJNË ME VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE**

**ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE**

**Shoqata "Refleksione"**

Rr. e Elbasanit, Pallatet "Fratari"  
Tershana 2, Kati I-re, Shk.2.  
Kutia Postare 2412/1, Tirane  
Tel./Fax: (04) 23 40433/4  
[refleksione@icc-al.org](mailto:refleksione@icc-al.org)

**Qendra e Keshillimit per Gra dhe Vajza**

Adresa: Rr. "Sami Frasheri"  
Pall. 9, Shk.5, Kutia Postare 2416/1,  
Tirane  
Tel.: (04) 2233408  
[qkgv@albn.net](mailto:qkgv@albn.net)

**Qendra per Nisma Ligjore Qytetare**

Rr.: "Vaso Pasha", Pall. 12, Shk. 1, Ap. 1  
Tirane  
Tel./Fax.: (04) 2241914  
[avokatore@albnmail.com](mailto:avokatore@albnmail.com); [aurboz@yahoo.com](mailto:aurboz@yahoo.com)

**Qendra e te Drejtave te Njeriut ne Demokraci**

Kutia Postare 2901, Tirane  
Tel./Fax: (04) 2230084  
[apronni@yahoo.com](mailto:apronni@yahoo.com); [hrdc@interalb.net](mailto:hrdc@interalb.net)

**Qendra Sociale per Gra dhe Vajza**

Lagjia 2, Pallati prapa Gjyqates,  
Durrës  
Tel./Fax: (052) 234600  
[shoqataegrave@yahoo.com](mailto:shoqataegrave@yahoo.com)

**Forumi i Gruas Elbasan**

Lagjia "5 Maji", rruga. "Fetah Ekmciu",  
Pall. 450/1, Elbasan  
Tel./Fax: (054) 255509, 240051  
[forumigruaselbasan@yahoo.com](mailto:forumigruaselbasan@yahoo.com)

**Gruaja te Gruaja**

Rr. "Marin Barleti", siper Kristalit  
perballe Kinemase Millenium, Shkoder  
Tel.: (022) 241154, (022) 245234  
[gtg@adanet.com.al](mailto:gtg@adanet.com.al)

**Qendra e Gruas "Hapat e Lehte"**

Rr. "Branko Kadia"  
Lagjia "3 Heronjte", Nr. 57, Shkoder  
Tel.: (022) 244 022  
[qendragruashk@yahoo.com](mailto:qendragruashk@yahoo.com)

**"The Door"**

Lagjia "Naim Gjylbegu"  
Rr. "Bujar Bishanaku", Shkoder  
Tel.: (022) 243729  
[thedor@infothedor.com](mailto:thedor@infothedor.com)

**Qendra e Keshillimit dhe e Sherbimeve  
Sociale Kukes**

Lagjia 2, prapa Hotelit "Gjallica", Kukes  
Tel.: (024) 224278, Cel.: 069 2244911  
[wcckukes@yahoo.com](mailto:wcckukes@yahoo.com)

**Qendra e Grave "Kristal"**

Pallati i Kultures "Margarita Tutulani"  
kati i I-re, Berat  
Tel.: (032) 231004  
[qkgv@yahoo.com](mailto:qkgv@yahoo.com)

**Ndihme Sociale Gruas Kryefamiljare**

Lagjia "Llukan Prifti", Kuçovë  
Cel: 069 2296445  
[teftansgk@yahoo.com](mailto:teftansgk@yahoo.com)

**Gruaja Korçare**

Bul. "Republika", Pall.3, A.1, Korçë  
Tel.: (082) 243563  
[korcawomen@yahoo.com](mailto:korcawomen@yahoo.com)

**Shoqata "Une Gruaja"**

Rr. "Reshit Çollaku", Pogradec  
Tel.: (083) 222140, Fax: (083) 225104  
[unegruaja@yahoo.com](mailto:unegruaja@yahoo.com)

**STREHËZA PËR GRATË**

**Streheza per Gra dhe Vajza, Tirane**

Tel: (04) 2261885

**Tjeter Vizion, Elbasan**

Tel/Fax: (054) 259657

**Qendra "Vatra", Vlorë**

Tel/Fax: (033) 224078, (033) 235533  
[qvatra@icc-al.org](mailto:qvatra@icc-al.org)

**Qendra Komunitare, Gjirokastr**

Tel.: (084) 268866, Cel: 069 20 59427  
[idrizi\\_bardha@yahoo.com](mailto:idrizi_bardha@yahoo.com)

**MBI LIGJIN PËR DHUNËN NË FAMILJE**

Në dhjetor **2006**, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi **ligjin "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"**, për t'u ardhur në ndihmë viktimave të dhunës në familje dhe për t'i mbrojtur ato (ligji mbi dhunën në familje).

Ligji parashikon se mund t'i drejtoheni një gjykate civile për marrjen e masave mbrojtëse në favorin tuaj përmes një procedure të shpejtë, të përballeshme dhe të thjeshtë. Mund të kërkoni një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje ndaj dhunuesit pa pagesë dhe pa patur domosdoshmërisht nevojën e një avokati mbrojtës. Këta urdhra mbrojtës vlejné dhe zbatohen në të gjithë Shqipërinë.

Kërkesa për një urdhër mbrojtjeje mund t'ju vë në rrezik, por edhe të qëndroni me një partner që ju dhunon mund të jetë tepër e rrezikshme. Dhuna mund ta shkatërrtojë jetën tuaj. Pra, besojini instiktin tuaj dhe bëni gjithçka mundeni për të mbrojtur veten.

Qëllimi i kësaj fletëpalosjeje është t'ju shpjegojë hapat që duhen ndjekur për t'i kërkuar gjyqtarit lëshimin e urdhrit mbrojtës kundër dhunuesit tuaj. Fletëpalosja ju informon se ku gjinden formularët e gatshëm të kërkesë-padive, të cilat mund t'i përdorni ju apo avokati juaj për t'i kërkuar gjykatës urdhrin mbrojtës. Gjithashtu, këtu gjeni edhe listën e organizatave jofitimprurëse të cilat mund t'ju ndihmojnë.

Për më shumë informacion rreth ligjit mbi dhunën në familje vizitoni faqen e internetit [www.osce.org.al](http://www.osce.org.al) ose [www.mpcs.gov.al](http://www.mpcs.gov.al) apo kontaktoni njërën prej organizatave të listuara në pjesën e pasme të fletëpalosjes.

Ky botim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë.



**MBRONI VETEN TUAJ  
NGA  
DHUNA NË FAMILJE**



**RRETH DHUNËS NË FAMILJE**

Dhuna në familje nuk është një çështje private që i përket vetëm familjes. Ajo është në kundërshtim me ligjin. Është një krim i rëndë, përbën një shqetësim për shëndetin publik dhe paraqitet në formën e dhunës fizike, psikologjike apo emocionale, kryer nga një partner intim aktual apo i mëparshëm ose nga anëtarë të familjes ndaj njëritjetrit.

Dhuna në familje është një fenomen i përhapur në shoqërinë tonë, ku rreth 30% e grave shqiptare perceptojnë se janë viktimat e kësaj forme abuzimi.<sup>1</sup> Kjo formë dhune ndodh në të gjitha klasat shoqërore dhe udhëhiqet nga nevoja për të pasur pushtet dhe kontroll ndaj një personi tjetër.

Dhuna përshkallëzohet dhe bëhet më e rëndë me kalimin e kohës nëse nuk merren masa për ta ndaluar atë. Në rastin më të keq, dhuna mund edhe të çojë në vrasje apo t'ju shtyjë në vetëvrasje.

Mos harroni - cilatdo qofshin rrethanat, dhuna nuk është faji juaj. Askush nuk meriton të abuzohet!

Tani, ligji mund t'ju mbrojtë ju dhe të afërmit tuaj nga dhuna në familje. Ja se çfarë mund të bëni për ta ndaluar dhunën.

1- "Dhuna bashkëshortore 1 ndër 3 bashkëshorte shqiptare", e disponueshme në adresën <http://www.newswise.com/articles/view/513263>.

### ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE?

Dhuna në familje është një formë abuzimi që synon ushtrimin e pushtetit dhe kontrollit ndaj një partneri intim ose ndaj një anëtari të familjes. Abuzimi mund të ndodhë në çdo kohë gjatë një marrëdhënieje, edhe pasi ajo të ketë përfunduar. Dhuna në familje përfshin:

**Sulme fizike**, duke përfshirë rrahjet, goditjet me grusht, shkelmimet, marrëdhëniet seksuale me dhunë ose sulmet me armë, izolimin me dhunë.

**Abuzimi emocional**, duke përfshirë sulmet verbale (si bërtitjet, etiketimet), izolimin nga shoqëria, frikësimin, kanosjet për dhunë apo për marrje të fëmijëve.

**Abuzimi ekonomik**, duke përfshirë vjedhjen e partnerit, mosdhënien e parave të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, shfrytëzimin e një personi për përfitime financiare, pengimin e partnerit që të punojë.

### ÇFARË ËSHTË NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Një **urdhër mbrojtjeje** është një vendim gjykate që e detyron dhunuesin të mos vazhdojë t'ju cenojë apo të kërcënojë se do t'ju cenojë, ju dhe anëtarët e familjes suaj. Për të marrë një urdhër, duhet të dilni përpara gjyqtarit në seancë gjyqësore (zakonisht ajo caktohet brenda 15 ditëve).

Personi që kërkon urdhrin e mbrojtjes quhet “paditësi”, kurse personi ndaj të cilit kërkohet urdhri quhet “i paditur”.

Nëse ndodheni **në rrezik të menjëhershëm** nga dhuna, gjykata mund të lëshojë **një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje** brenda 48 orëve nga kërkesa juaj. Ky është një urdhër i përkohshëm, i cili vlen derisa të lëshohet një urdhër i zakonshëm, zakonisht brenda 20 ditëve (përveç rastit kur gjykata vendos ta ndërpresë atë).

Të **dy urdhrat** hyjnë në fuqi menjëherë pasi lëshohen nga gjykata dhe janë **të vlefshëm në të gjithë Shqipërinë**.

#### Ç’LLOJ MBROJTJEJE MUND TË GJEJ?

Një urdhër mbrojtjeje e urdhëron dhunuesin të kryejë apo të mos kryejë veprime të caktuara. Për shembull, **një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje** mund të:

- urdhërojë dhunuesin të ndalojë së kryeri ose së kërcënuari se do të kryejë akte të dhunës në familje kundër jush, fëmijëve tuaj apo anëtarëve të familjes;

- urdhërojë dhunuesin të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose komunikojë me ju, me anëtarët e familjes përmes telefonit, postës, e-mail-it ose përmes një pale të tretë;

- largojë dhunuesin nga banesa juaj ose nga banesa e përbashkët për një periudhë kohe të caktuar (nuk ka rëndësi se kush e zotëron pronësinë e banesës);
- ndalojë dhunuesin t'i afrohet shtëpisë dhe punës suaj ose shkollës së fëmijëve;

- ndalojë dhunuesin të takojë fëmijët tuaj;

- urdhërojë dhunuesin të dorëzojë armët që zotëron.

Përveç sa më sipër, një **urdhër mbrojtjeje** mund t'ju:

- japë kujdestarinë e përkohshme të fëmijëve;
- lejojë të zotëroni banesën në përdorim të përbashkët ose pjesë të saja;
- të urdhërojë dhunuesin të paguajë qeranë si dhe të mbështesë financiarisht ju dhe fëmijët tuaj.

#### SIMUND TË KEM NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Mund të kërkonti një urdhër mbrojtjeje duke paraqitur një **KËRKESË-PADI** (me shkrim) **në ÇDO GJYKATË CIVILE**.

Orari i gjykatave të rrethit është nga e hëna në të premte, ora 08.00-16.00.

Nëse keni nevojë për ndihmë të menjëhershme, mund ta paraqisni kërkesën edhe në komisariatin më të afërt policor. Policia më pas duhet të kontaktojë me gjyqtarin e gatshëm, i cili mund të lëshojë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

Në çdo rast gjykata jep dy kopje të vendimit për urdhër mbrojtjeje. Një kopje mbajeni për përdorim personal dhe një kopje për t'ia paraqitur policisë nëse do të jetë e nevojshme.

#### A MUND TË KËRKOJ NDIHMË NË LIDHJE ME APLIKIMIN PËR NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Një avokat pa pagesë mund ta përgatisë kërkesë-padinë dhe ta paraqesë atë. Nëse nuk ndodh kështu, disa oranizata jofitimprurëse mund t'ju ndihmojnë për të aplikuar (shihni listën në faqen e pasme). Shërbimet e tyre janë falas. Mund t'i plotësoni **formularët standard** (të disponueshëm në <http://www.osce.org/albania/13143.html>) ose ta plotësoni me shkrim kërkesë-padinë, në mënyrë që të jetë e lexueshme.

**Mos harroni**—është e rëndësishme që në kërkesë-padi të **shpjegoni nga se keni frikë**. Shpjegoni se si u dëmtuat, si dhe tregoni për aktet dhe kërcënimet e dhunshme. **Tregohuni i/e saktë** për datat, vendet, dëmtimet dhe armët që u përdorën, nëse kishte të tilla.

#### SA PARA DO TË KUSHTOJË KËRKESA PËR NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Asgjë, nëse urdhri lëshohet. Nëse kërkesa refuzohet, do t'ju duhet të paguani shpenzimet gjyqësore dhe ligjore.

#### A DUHET TË JEM I/E MARTUAR ME DHUNUESIN QË TË KËRKOJ NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Jo. Urdhri i mbrojtjes mbulon disa marrëdhënie:

- bashkëshortë/ish-bashkëshortë, partnerë bashkëjetues/ish-partnerë bashkëjetues;
- vëllezër, motra, gjinia në vijë të drejtë (përfshirë perindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar); fëmijët dhe bashkëshortët e këtyre personave;
- gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit dhe fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- vëllezër dhe motra të bashkëshortëve nëse këta kanë jetuar bashkë gjatë 3 muajve të fundit.

#### SI MUND TA BIND GJYKATËN SE JAM VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE?

Për të bindur gjyqtarin se ka patur me të vërtetë dhunë, duhet të jepni sa më shumë detaje të jetë e mundur duke përfshirë **datën dhe vendin e incidentit, llojin e dëmtimeve fizike** dhe **emrat e dëshmitarëve**, nëse ka patur të tillë. Nëse është e mundur, **bëni fotografi të plagëve** që janë shkaktuar nga dhuna dhe merrini të gjitha me vete në seancë gjyqësore.

Dorëzoni edhe raportet e policisë dhe të mjekut mbi gjitha incidentet (të ndodhura më parë apo së fundmi), si dhe ndonjë **urdhër të mëparshëm mbrojtjeje** dhe **urdhër arresti**.

Kur ju jepet trajtim mjekësor për plagët, sigurohuni t'i thoni mjekut që të shkruajë ato që kanë ndodhur, duke dhënë edhe emrin e dhunuesit.

#### PËR SA KOHË ËSHTË I VLEFSHËM NJË URDHËR MBROJTJEJE?

Kohëzgjatja e një urdhri mbrojtjeje vendoset nga gjykata, në maksimum deri në 12 muaj.

Të paktën 15 ditë përpara se urdhri i mbrojtjes të skadojë, ju ose një person i autorizuar prej jush mund të shkoni në gjykatë dhe të kërkonti vazhdimin e tij.

#### NËSE KËRKOJ NJË URDHËR MBROJTJEJE, A DO TË SHKOJË DHUNUESI NË BURG?

Jo. Një urdhër mbrojtjeje është një veprim civil, jo penal. Ai e ndalon dhunuesin që t'ju afrohet. Qëllimi i tij është që t'ju mbrojë ju dhe fëmijët tuaj nga dhuna e mëtejshme. Për sa kohë dhunuesi nuk e shkel urdhrin apo nuk kryen ndonjë vepër penale, ai nuk do të arrestohet.

#### Ç’DUHET TË BËJ NËSE DHUNUESI THYEN URDHRIN E MBROJTJES?

**Denonconi menjëherë në polici** mbi shkeljet, duke i treguar policisë kopjen e urdhrit. Policia duhet të shkruajë një raport dhe t'ju japë një kopje të tij. Shembuj të thyerjes së urdhrit janë: ju telefonon në punë ose shtëpi; vjen në shtëpi ose viziton fëmijët në shkollë; ju sulmon apo kërcënon.

Thyerja e urdhrit përbën një vepër penale. Dhunuesi mund të gjobitet apo dënohet me burgim deri në 2 vjet.

#### NËSE MARR NJË URDHËR MBROJTJEJE, A MUND TË NIS EDHE PROCEDIM PENAL KUNDËR DHUNUESIT?

Po, mundeni. Për shembull, nëse dhunuesi ju ka kërcënuar, dëmtuar, ose ka rrëmbyer fëmijët tuaj, ju mund të shkoni në polici dhe ta akuzoni penalisht atë. Procedimet penale dhe civile janë të ndara nga njëra-tjetra. Ju mund të merrni një urdhër mbrojtjeje edhe nëse i padituri deklarohet i pafajshëm nga gjykata penale. Po ashtu, ju mund të ngrini një akuzë penale edhe nëse nuk ju jepet një urdhër mbrojtjeje. Me pak fjalë, mund të ndërmerri secilën nga këto dy masa ose të dyja bashkë.

#### A MUND TA NDRYSHOJ APO TA ANULOJ URDHRIN?

Po. Ju ose avokati juaj mund të kërkonti që urdhri i mbrojtjes të ndryshojë ose të ndërpritet kur rrethanat “kanë ndryshuar rrënjësisht”. Gjikata merr një vendim pasi ka zhvilluar një seancë gjyqësore. Deri atëherë, urdhri mbetet në fuqi - vendimi juaj (si p.sh., për t'u kthyer e për të jetuar me dhunuesin) nuk mjafton për ta ndryshuar atë.

#### KË MUND TË TELEFONOJ PËR NDIHMË?

Në situata kulmore, **telefononi policinë** në numrin **129**.

Mund të telefononi edhe një prej **organizatave jofitimprurese** që japin ndihmë për viktimat e dhunës në familje (shih listën në pjesën e pasme). Nëse doni të largoheni nga shtëpia juaj dhe keni nevojë për strehim të menjëhershëm telefononi strehëzat si më poshtë:

Tiranë (04)2261885	Elbasan (054)259657
Vlorë (033)224078	Gjirokastër (084)268866.